Rev.nr.172/2020

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Beshir Islami, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit A.M. nga fshati ..., Komuna e ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Xh. M., avokat nga ..., kundër të padituës K. e S. "K. e R." me seli në Prishtinë, për kompensim të dëmit material dhe jo material, duke vendosur sipas revizionit të padituës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.3712/2016, datë 12.11.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 4.5.2020, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të padituës, K. e S., "K. e R." me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.3712/2016, datë 12.11.2019.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Prishtinë, Ac.nr.3712/2016, datë 12.11.2019, refuzohet si e pabazuar ankesa e të padituës K. e S. "K. e R." me seli në Prishtinë, dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.11/15 datë 30.8.2016, me të cilin në par. I të dispozitivit, aprovohet pjesërisht padia dhe kërkesëpadia e paditësit A. M. nga fshati ...,

Komuna e ..., ashtu që në par. II të dispozitivit, obligohet e paditura Kompania e Sigurimeve "Kosova e Re" me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit për të gjitha format e dëmit material dhe jo.material, të shkaktuara në aksidentin e datës 2.11.2006, në Vushtrri, paditësit A. M. nga ..., t'ia paguaj shumën totale prej 7.400 € dhe atë: në emër të dhimbjeve fizike, shumën totale prej 2.000 €, në emër të frikës së pësuar, shumën totale prej 1.500 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 10%, shumën prej 1.500 €. Në emër të ndihmës së personit tjetër, shumën prej 2.500 €, në emër të ushqimit të përforcuar në kohëzgjatje prej 2 muaj, shumën prej 150 €, në emër të rehabilitimit fizioterapeutik, shumën prej 2.000€, në emër të fitimit të humbur si pasojë e zvogëlimit të aktivitetit të punës në shkallë prej 20%, shumën totale prej 1.800€. Me këtë aktgjykim është ndryshuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë vetëm përkitazi me llogaritjen e datës së kamatës, ashtu që është gjykuar kamata ligjore si për mjetet e deponuara në bankat komerciale në Kosovë, mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 30.8.2016, e deri në pagesën definitive. Aktgjykimi i atakuar në par. IV, mbetet i pashqyrtuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës të shkallës së dytë, revizion ka ushtruar e paditura, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që revizioni të pranohet në tërësi si i bazuar dhe aktgjykimet e të dy gjykatave të prishen dhe lënda ti kthehet në rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të aktgjykimit të goditur dhe pretendimeve në revizion, në mbështetje të dispozitës së nenit 215 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK) gjeti se:

Revizioni i të padituës, është i pabazuar.

Nga shkresat në lëndë rezulton se më datën 30.9.2017, në fshatin ... , Komuna e ..., ka ndodhur aksidenti i komunikacionit në të cilin paditësi A. M., nga fshati ..., si këmbësor ka pësuar lëndime trupore. Aksidentin e ka shkaktuar vozitësi i automjetit "Opel-Kadet" me targa regjistrimi ...,i siguruar te e paditura, e të cilin e ka drejtuar A. B., i cili në mënyrë të paligjshme ka bërë veprimin e tejkalimit dhe duke dalë në anën e kundërt të kësaj rruge e godet automjetin që ka lëvizur në drejtim të kundërt të markës''...''me targa ..., të cilin e ka drejtuar I. M., dhe në atë rast ky I fundit nga kjo goditje del nga rruga dhe e godet paditësin, duke ecur në trotuar dhe me atë rast i shkakton lëndime të rënda trupore.

Gjykata e shkallës së parë në cilësi të prove materiale ka administruar provë me ekspertin e komunikacionit H. P. të datës 30.9.2007,i cili ka konstatuar se aksidenti i komunikacionit i datës 2.11.2006 në fshatin ..., ka ardhur si pasojë e lëshimeve primare dhe ekskluzive të automjetit të markës "Opel Kadet", me tabela regjistrimi ..., i cili ishte i siguruar tek e paditura.

Gjykata në cilësi të provës materiale ka administruar ekspertizën mjekësore nga ekspertët mjekësorë dr. S. D.-ortoped traumatolog dhe dr. B. O.-psikiatër, të cilët në mendimin dhe konstatimet e tyre mjekësore kanë deklaruar se paditësi, si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 2.11.2006, ka pësuar lëndime të rënda trupore, e si pasojë e këtyre lëndimeve, paditësi ka përjetuar dhimbje fizike, frikë, vuajtje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor në shkallë prej 10 %. Sipas konstatimit të ekspertëve për shkak të lëndimeve të pësuara, paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë, për ushqim të përforcuar, terapi fizio terapeutike, si dhe zvogëlim të aktivitetit punues në shkallë prej 20%. Gjykata duke u bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike e duke u bazuar në dispozitën e nenit 185, 186, 188, 189, 190, 192,195 dhe 200 të LMD-së, paditësit në emër të dëmit material dhe jo material, ka gjykuar shumat si në vijim: për dhimbje fizike shumën

prej 2.000 €, për dhimbje shpirtërore, për shkak të frikës shumën prej 1.500 €, për dhimbje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 1.500 €, në emër të dëmit material për ndihmën e personit të tretë shumën prej 2.500 €, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 1.500 €, në emër të rehabilitimit fizio terapeutik shumën prej 200 €, në emër të fitimit të humbur si pasojë e zvogëlimit të aktivitetit të punës në shkallë prej 20% shumën totale prej 1.800 €, të gjitha këto me kamatë sipas lartësisë që paguhet në mjetet e afatizuara, pa destinim të caktuar në bankat afariste për një vit, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë, deri në pagesën definitive. Poashtu, në pikën III të dispozitivit, obligohet e paditura që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë totale prej 1.185 €.

Gjykata e Apelit në procedurë të ankimimit, ka refuzuar si të pa themeltë ankesën e të padituës, përveç pjesës që ka të bëjë me datën e llogaritjes së kamatës, duke vlerësuar se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Gjendja faktike është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë edhe sa i përket përgjegjësisë së të padituës për kompensimin e dëmit. Gjykata e shkallës së dytë, i vlerëson si të pa qëndrueshme pretendimet në ankesë lidhur me vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, zbatimin e gabuar të së drejtës materiale si dhe lartësinë e shumave të gjykuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së dytë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që gjykata e shkallës së dytë drejt i ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe se të padituat kanë përgjegjësi për kompensimin e dëmit të cilin paditësi e ka përjetuar në aksidentin e komunikacionit. Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje

thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 215 të LPK-së. Gjykata e shkallës së dytë, duke u bazuar në Mendimin dhe Konstatimin e ekspertit të komunikacionit Hilmi Peci, në aktgjykimin e saj ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike lidhur me përgjegjësinë e të padituës për kompensimin e dëmit pasiqë nga ana e ekspertit të komunikacionit është vërtetuar pa dyshim se fajtori kryesor për shkaktimin e dëmit është drejtimi jo i ligjshëm i automjetit nga ana e të siguruarit të padituës dhe se nuk ka lëshime nga pjesëmarrësit tjerë në komunikacion e aç më pak në anën e paditësit i cili është i pa- fajshëm, e po ashtu edhe pjesëmarrësi në aksident, drejtuesi i automjeti ''Mitcubishi'',ka qenë duke lëvizë në drejtimin e vet dhe sikur i siguruari i të padituës të mos kishte ndërmarr veprimin e pa ligjshëm - tejkalimin jo të rregullt të automjetit tjetër në asnjë mënyrë nuk do të kishte ardhur te aksidenti përkatësisht lëndimi i paditësit. Prandaj, janë të paqëndrueshme pretendimet në revizionin e të padituës se aktgjykimi i goditur dhe ai i gjykatës së shkallës së parë, janë marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale lidhur me zbatimin e institutit të përgjegjësisë së padituës në shkaktimin e dëmit.

Gjykata Supreme po ashtu vlerëson se shumat e gjykuara të dëmit jo material paditësit në emër të dhimbjeve të pësuara fizike, frikës dhe zvogëlimit të aktivitetit jetësor janë reale, janë caktuar në bazë të ekspertizës së ekspertëve mjekësorë dr.S.D. ortoped-traumatolog dhe dr. B. O., psikiatër. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për këto forma të dëmit, gjykata e shkallës së parë sipas nenit 200 të LMD, është kujdesur për rëndësinë e të mirës së dëmtuar dhe qëllimin të cilit i shërben ai shpërblim, por edhe për çështjen që të mos favorizohen synimet të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të tillë të dëmit jo material dhe qëllimin shoqëror. Duke pasur parasysh kriteret e parapara me këtë dispozitë, ka vërtetuar se kompensimi i dëmit është adekuat me natyrën e lëndimit, kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike, frikës dhe shkallën e zvogëlimit të aktivitetit

jetësor. Prandaj, edhe kjo Gjykatë vlerëson se shumat e gjykuara paditësit për këto forma të dëmit jo material, paraqesin shpërblim të drejtë dhe një formë të satisfakcionit për paditësin i cili me këto mjete mund të plotësoj nevojat e ndryshme jetësore të tij, dhe për më tepër, ato, janë në përputhje edhe me praktikat gjyqësore për gjykim për këto forma të dëmit.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate drejt është zbatuar e drejta materiale nenet 194,195 të LMD-së, përkitazi me shumat e gjykuara paditësit në emër të kompensimit të dëmit material për ushqim të përforcuar, për ndihmën dhe kujdesin e huaj, shpenzimet si dhe rehabilitimit fizioterapeutik, pasi që këto forma të dëmit janë caktuar duke u bazuar në mendimin dhe konstatimin e mjekëve ekspertë dhe duke pranuar standardet e praktikës gjyqësore nga e cila rrjedhë se mundë të kompensohet dëmi për këtë kategori në lartësi prej 5 deri 10 €, në ditë, edhe nëse pala nuk disponon me fatura, por është konstatim i ekspertit mjekësor se paditësi ka pasur nevojë për këto shërbim. Poashtu drejtë është zbatuar e drejta materiale edhe lidhur me shumën e gjykuar për shpenzimet e mjekimit, pasiqë kjo shumë është në harmoni me vlerën e shpenzimeve për të cilat pala paditëse ka prezantuara prova, dhe përgjegjësia e të paditurës është që paditësit t'ia kompensojë edhe shpenzimet e mjekimit. Kjo Gjykatë nuk e vlerësoi aktgjykimin e goditur ndaj shumës së gjykuar në emër të dëmit material për zvogëlimin e aktivitetit të punës, për paditësin për arsye se, në revizion nuk ka pasur pretendime lidhur me shumën e gjykuar për këtë formë të dëmit.

Nuk qëndrojnë pretendimet në revizion se, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, ndaj lartësisë së shumave të gjykuara për format e sipërcituara të dëmit jo material dhe material, për arsye se, këto forma të dëmit janë konstatuar nga ana e ekspertëve mjekësorë kështu- që pretendimet në revizion nuk e vejnë në dyshim ligjshmërinë e aktgjykimit të kundërshtuar për faktin se gjykata e shkallës së dytë në arsyetim të

aktgjykimit ka dhënë arsye të plota dhe të mjaftuara për natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditësi si dhe për rrethanat që lidhen me kategorinë dhe lartësinë e shumave të gjykuara për çdo formë të dëmit. Prandaj, pretendimet e ngritura ne revizionin e të padituës lidhur me shumat e gjykuara për këto forma të dëmit u refuzuan si të pa bazuara.

Po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet në revizion se gjykata e shkallës së parë ka gjykuar shumat më të larta për një dëmshpërblim i cili është kompensuar nga e paditura në procedurën e ekzekutimit, në shumë prej 15.410,70 €, duke konsideruar se ky është pasurim pa bazë .Kjo për faktin se, në bazë të nenit 216 të LMD-së, është përcaktuar se:'' Nuk mund të kërkohet kthimi i shumave të paguara pa bazë në emër të shpërblimit të dëmit për shkak të lezionit trupor, të prishjes së shëndetit ose vdekjes në qoftë se pagesa i është bërë marrësit mirëbesues''. Ngjashëm me këtë dispozit është edhe dispozita e nenit 199 par 2 të LMD-së, ku përcaktohet se:'' Si shumë e paguar pa bazë llogaritet edhe pagesa mbi bazën e një vendimi gjyqësor që më vonë është ndryshuar ose prishur''.

Objekt i shqyrtimit ishin edhe pretendimet në revizion se e paditura nuk ka pasur ftesë për seancën e shqyrtimit kryesor dhe se në hyrjen e aktgjykimeve të dy gjykatave është shënuar emri i përfaqësuesit të padituës R. A., i cili nuk ka qenë në jetë në kohën e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Pretendimet e këtilla u refuzuan pasi që këto pretendime nuk e bëjnë aktgjykimin e goditur të kundërligjshëm ashtu si pa bazë theksohet ne revizion, për arsye se nga fletë kthesat që gjenden në shkresat e lëndës rezulton se, gjykata e shkallës së parë, ftesat për seancë nuk ia ka dorëzuar përfaqësuesit të padituës por të padituës, e cila në dy seancat e fundit nuk i është përgjigjur ftesave të gjykatës edhe pse ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt, nuk ia ka njoftuar gjykatën se përfaqësuesi i saj nuk është në jetë, kështu që për lëshimet e veta e paditura nuk mund ta fajësojë gjykatën.

Kjo Gjykatë, i vlerësoi si të pabazuara, pretendimet në revizion se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ngase në revizion nuk është cekë asnjë pretendim konkret për atë se ku qëndrojnë shkeljet e pretenduara, ndërsa sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, dispozitivi i aktgjykimit në pjesën e goditur, është i qartë dhe i ekzekutueshëm, është në harmoni me arsyetimin dhe me provat ekzistuese në lëndë. Gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj ka dhënë arsye për të gjitha pretendimet e palëve, të cilat arsye janë të mjaftueshme për një gjykim të drejtë e të ligjshëm, ndërsa kjo Gjykatë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë nuk ka gjetur shkelje të procedurës për të cilat kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 215 të LPK-së.

Nga sa u tha më sipër me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.172/2020 datë 4.5.2020

Kryetare e kolegjit,

Gyltene Sylejmani